



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

UDHËZIM

“Për caktimin e shpërblimit të anëtarëve joekzekutivë të Bordit dhe pagës së Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Nëndrejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”

Miratuar me vendim Bordi nr. 76, datë 28.07.2015

Ndryshuar me vendim Bordi nr. 92 datë 27.06.2016

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i shpërblimit të anëtarëve jo ekzekutivë të Bordit, si dhe pagës së Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Nëndrejtorit Ekzekutiv, dhe punonjësve të Autoritetit.

Neni 2

Klasifikimi i vendeve të punës në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

2.1 Çdo vend pune në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare përcaktohet dhe klasifikohet sipas **niveleit, klasës dhe grupit** në mënyrën e përshkruar në këtë udhëzim.

2.2 Në funksion të llojit dhe të përgjegjësisë së punës në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare ka **katër nivele** punësimi (ndarje vertikale) si më poshtë:

- a) Niveli i lartë i drejtimit (niveli i parë).
- b) Niveli i mesëm i drejtimit (niveli i dytë).
- c) Niveli i shërbimit profesional (niveli i tretë).

d) Niveli i shërbimit të përgjithshëm (niveli i katërt).

2.3 Në funksion të llojit dhe të profilit të punës, në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare ka **pesë klasa** punësimi (nëndarje vertikale) si më poshtë:

Klasa I	Drejtor i Departamentit
Klasa II	Drejtor i Drejtorisë
Klasa III	Përgjegjës Sektori
Klasa IV	Specialist profesionist
Klasa V	Personel ndihmës

2.4. Për shkak të përvojës profesionale dhe profilit të vendit të punës, klasa IV ndahet në tre grupe: grupi A, grupi B dhe grupi C. Vendet përkatëse të punës klasifikohen si më poshtë:

- a) Në grupin “A” përfshihet specialisti i një profesioni të vecantë, i quajtur *aktuar*.
- b) Në grupin “B” përfshihen vendet e punës: *specialist me arsim të lartë me eksperiencë pune mbi dy vjet*.
- b) Në grupin “C” përfshihen vendet e punës: *specialist me arsim të lartë me eksperiencë pune më pak se dy vjet*. Në këtë grup përfshihet edhe sekretari i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

2.5. Për shkak të profilit të vendit të punës, klasa V ndahet në 4 grupe. Vendet përkatëse të punës klasifikohen si më poshtë:

- a) Në grupin “A” përfshihet: vendi i punës së punonjësit të protokollit dhe arkivës;
- b) Në grupin “B” përfshihet: magazinier, punonjës sigurimi;
- c) Në grupin “C” përfshihet: shofer;
- d) Në grupin “D” përfshihet: punonjës pastrimi.

2.6 Lidhja ndërmjet niveleve, klasave dhe grupeve paraqitet në **tabelën 1**.

Neni 3

Mënyra e përfitimit të vendit të punës

Përfitimi i një vendi të caktuar pune apo kalimi nga një nivel në një tjetër, nga një klasë në një tjetër dhe nga njëgrup në një tjetër kushtëzohet nga nevojat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për secilin vend pune dhe mundësohet duke u bazuar në kualifikimin e kërkuar për një vend të caktuar pune, në rezultatet e arritura në punë, sipas politikës së punësimit në AMF.

Neni 4

Shpërblimi i Kryetarit dhe anëtarëve joekzekutivë të Bordit të AMF

4.1 Shpërblimi i Kryetarit dhe anëtarëve joekzekutivë të Bordit të AMF do të bëhet mbi bazë mujore.

4.2 Shpërblimi i Kryetarit të Bordit të AMF është në masën 35% e pagës bruto mujore të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

4.3 Shpërblimi i anëtarëve joekzekutivë të Bordit të AMF është në masën 25% e pagës bruto mujore të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

Neni 5

Struktura e pagës në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare

Paga mujore bruto e nivelit të lartë dhe të mesëm të drejtimit, të nivelit të shërbimit profesional dhe nivelit të shërbimit të përgjithshëm përbëhet nga paga bazë dhe shtesat mbi pagë.

Neni 6

Paga bazë dhe përcaktimi i saj

6.1 **Me pagë bazë** në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare do të kuptojmë një shumë materiale fillestare mujore, të shprehur në vlerë dhe të lidhur me çdo nivel, klasë (apo grup) pune në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Paga bazë e çdo niveli, klase dhe grupi përcaktohen në **tabelën 2**, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6.2 Për caktimin e pagës bazë mbahet parasysh rëndësia e secilit vend pune, në hierarkinë e përgjithshme të strukturës organizative të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe niveli i

pagave për vende të njëjta ose të ngjashme, pune të tregut të punës. Çdo ndryshim në pagën bazë mujore bëhet me vendim të Bordit të AMF, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

6.3 Paga bazë mujore rritet kur indeksohet në lidhje me inflacionin, kur justifikohet nga rritja e ekonomise, kur justifikohet me ndryshime strukturore në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, si edhe për të përballuar konkurrencën e tregut të punës. Bordi i AMF miraton rritjen e pagës bazë mujore sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

Neni 7

Shtesat mbi paga

7.1 Të gjitha shtesat në përqindje llogariten mbi pagën bazë mujore. Ato reflektojnë vlera apo ndryshime cilësore ekzistuese apo të lidhura për shkak të natyrës dhe të rëndësisë së secilit vend pune apo individ në arritjen e objektivave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Shtesat mbi pagë janë të klasifikuara si më poshtë:

1. shtesë për klasifikim njësie organizative,
2. shtesë për vjetërsi në punë,
3. shtesë për tituj shkencorë.

7.2 Shtesat llogariten si përqindje apo shumë fikse mbi pagën bazë mujore.

7.3 Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Nëndrejtori Ekzekutiv (niveli i lartë i drejtimit) përfitojnë vetëm shtesë për klasifikim njësie organizative.

Neni 8

Shtesa për klasifikim njësie organizative

Shtesa (1) për klasifikim njësie organizative përfitohet nga punonjësit, bazuar në ndarjen që i bëhet njësive organizative, nisur nga rëndësia që ato kanë në arritjen e objektivave të Autoritetit. Bazuar në këtë konceptim, njësitë organizative ndahen në disa kategori. Ndarja e njësive organizative dhe % për çdo njësi jepet në **tabelën 3**.

Neni 9

Shtesa për vjetërsi në punë

9.1 **Shtesa (2) për vjetërsi në punë** është shtesa mbi pagë, që bazohet në vitet e punës së cdo punonjësi. Shtesa për vjetërsi do të llogaritet në masën 1% për cdo vit vjetërsie në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe 0.5% për cdo vit tjetër pune. Totali i viteve të vjetërsisë, të llogarituara për efekt të shtesës mbi pagë do të jetë jo më shumë se 25 vjet.

9.2 Për personelin ndihmës, shtesa për vjetërsi llogaritet 0.5% për cdo vit pune, por jo më shumë se 25 vjet.

Neni 10

Shtesa për tituj shkencorë

10.1 **Shtesa (3) për tituj shkencor dhe bonuse për punë kërkimore** jepet përata punonjës të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që kanë grada shkencore (ose grada të barazvlefshme me to) apo tituj shkencorë (ose tituj të barazvlefshëm me ta).

10.2 Shtesa mbi pagë për grada/tituj shkencorë jepet në masën e mëposhtme:

Profesor (Drejtues kërkimesh)	shtesë 11,000 lekë
Profesor i asociuar (Mjeshtër kërkimesh)	shtesë 9,500 lekë
Doktor i shkencave (Ph.D)	shtesë 6,500 lekë

10.3 Proçedura për përfitimin e shtesave të mësipërme nis me paraqitjen nga punonjësi pranë njësisë organizative të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare që mbulon çështjet e burimeve njerëzore, të një përmbledhje të temës ose çështjeve të trajtuara për mbrojtjen e titullit të fituar.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi më datë 1.08.2015.

Tabela 1 – Lidhje ndërmjet niveleve,klasave dhe grupeve

Niveli	Klasa				
Nivel i lartë drejtues (nivel i parë)					
Nivel i mesëm drejtues (nivel i dytë)	Klasa I				
	Klasa II				
Nivel i shërbimit profesional (nivel i tretë)	Klasa III				
	Klasa IV	Grupi A	Grupi B	Grupi C	
Nivel i shërbimit të përgjithshëm (niveli i katërt)	Klasa V	Grupi A	Grupi B	Grupi C	Grupi D

